

“Edukimi për një të ardhme më të suksesshme”

Financuar nga UNDP/ Kuvendi Komunal Prizren

Nëntor 2009-Mars 2010

Ky projekt ka filluar të implementohet nga fundi i muajit nëntor dhe ka zgjatur deri në muajin mars 2010. Qëllimi kryesor cili ishte i paraparë me projekt ka qenë - ngritja e nivelit të shkollimit efektiv të fëmijëve nga komunitetin RAE dhe përmirësimi i kushteve të arsimimit të tyre.

Ndër objektivat e projektit të adresuara ishin:

- Rritja e vetëdijes tek komuniteti i prindërve dhe familjarëve për çështjen e kyçjes së fëmijëve në shkollë,
- Përkrahja e grupit të fëmijëve nga komuniteti RAE me qëllim të përgatitjes së të gjitha segmenteve për regjistrimin e tyre në shkollë,
- Mundësimi i përkrahjes dhe bashkëpunimit institucional në sferat e regjistrimit të fëmijëve dhe edukimit të tyre të pandërprerë,

Janë parashikuar dhe janë realizuar rezultatet në vijim:

- Vlerësimi i gjendjes dhe nevojave të komunitetit RAE përmes pyetësorit i cili është organizuar me komunitetin për të kuptuar problemin dhe arsyet për edukimin të dobët, dhe për shkallen e gatishmërisë së komunitetit për përkrahjen e arsimimit,
- Rritja e nivelit të vetëdijes te prindërit për çështjen e regjistrimit të fëmijëve,
- Rritje e nivelit të perceptimit të komunitetit RAE për shkollimin dhe arsimimin përmes kampanjës,
- Përkrahja psikosociale në rastet e familjeve me vështirësi adaptuese,
- Ulja e nivelit të stereotipeve përmes shtimit të pranimit të fëmijëve RAE nga ana e fëmijëve të tjerë sidomos në shkolla,
- Ngritja e interesimit për vazhdimësinë e shkollimit të fëmijëve në klasat më të larta,
- Ekzistimi i punëtorëve kompetent në të gjitha shkollat të cilët do t'u japin përkrahje të drejtpërdrejtë fëmijëve RAE për lehtësimin e regjistrimit në shkolla
- Formimi i forumit të prindërve RAE që do të jetë aktiv në fushën e arsimit dhe problematikës së fëmijëve
- Vëmendje e veçantë e drejtuar te fëmijët RAE përmes ofrimit të orëve plotësuese,
- Involvimi i prindërve nga komuniteti RAE në këshillin prindëror të shkollave (kusht për të gjitha shkolla),
- Përfshirja më intenzive e Departamentit për arsim dhe institucioneve të tjera në problematikën e shkollimit RAE,

Realizimi i këtyre objektiveve është bërë përmes këtyre aktiviteteve:

- Krijimi dhe funksionalizimi i Forumit të prindërve të komunitetit RAE, si një OJQ e pavarur,

- Mbajtja e konferencës për shkollimin e RAE me të gjitha faktorët dhe autoritetet komunale,
- Trajnimit për ngritjen e kapaciteteve për Forumin e Prindërve RAE,
- Mbajtja e debateve,
- Kampanja : broshurat, posterat, studiot e hapura etj.